

**RËPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER AMELA MUKAJ**



V2022053940182475754

DATE 03/06/2022  
NR REP 2904



**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Para meje Notere AMELA MUKAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Kamez, NJESIA ADMINISTRATIVE KAMEZ, RR. BULEVARDI BLU, GODINA ARBEN DEDJA, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUESIT:**

**Ilirian Laçi**, atësia Faik, amësia Adile, shtetas Shqiptar, lindur në Burrel dhe banues në TIRANË, me adresë Asim Vokshi, Nd. 14; H. 6; Ap. 36; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 10/08/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033830641 dhe nr. personal I00810063K . .

**Benard Shehu**, atësia Vladimir, amësia Xhemile, shtetas Shqiptar, lindur në Ballsh, Fier dhe banues në TIRANË, me adresë Blv. Zhanë D'ark; Nd. 113; H. 4; Ap. 26; Njësia Administrative Nr. 3; Njësia Bashkiake Nr. 3; 1005; Tiranë, lindur më 14/01/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037114589 dhe nr. personal I00114104E . .

**Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Statutin dhe aktin e themcimit te shoqerise tregtare 'TIRANA POLYCLINIC'SH.P.K, bashkëlidhur.**

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTERE**

**AMELA Q.MUKAJ**



**STATUTI  
DHE AKT I THEMELIT TE  
SHOQËRISË TREGTARE  
"TIRANA POLYCLINIC" SH.P.K**

Në Tiranë, sot më 24/05/2022 (dymijë e njezet e dy), para meje Noteres Amela Mukaj anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, në Rr "Bulevardi Blu Kamez", u paraqitën personalisht:

1. **Ilirian Laçi**, atësia Faik, amësia Adile, shtetas Shqiptar, lindur në Burrel dhe banues në TIRANË, me adresë Asim Vokshi; Nd. 14; H. 6; Ap. 36; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 10/08/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033830641 dhe nr. personal I00810063K, .
2. **Benard Shehu**, atësia Vladimir, amësia Xhemile, shtetas Shqiptar, lindur në Ballsh, Fier dhe banues në TIRANË, me adresë Blv. Zhanë D'ark; Nd. 113; H. 4; Ap. 26; Njësia Administrative Nr. 3; Njësia Bashkiake Nr. 3; 1005; Tiranë, lindur më 14/01/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037114589 dhe nr. personal I00114104E, .

Te cilet me vullnet te lire dhe te pavesuar deklaruan se: "në përputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshem në Republikën e Shqipërisë, formulojmë dhe miratojmë këtë Statut dhe Akt Themelimi sipas termave të mëposhtme:

**EMËRTIMI -OBJEKTI- SELIA – KOHËZGJATJA- ORTAKET**

**NENI 1- EMËRTIMI I SHOQËRISË**

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "TIRANA POLYCLINIC" sh.p.k , më poshtë e quajtur "Shoqëria". Ky emërtim do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj dhe i reklamuar ne seline e shoqërisë.

**NENI 2- SELIA**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njesia Bashkia nr. 3, Bulevardi "Zhan D'Ark", Ndertesa nr. 111, Kodi Postar 1005, Tirane.
- 2.2 Shoqëria mund të hapë edhe vend qëndrime të tjera si filiale, përfaqësi, degë, agjensi, etj., në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë dhe ne cdo shtet tjetër te huaj, me miratim të asamblesë së përgjithshme dhe në përputhje me ligjet e vendit apo shtetit përkatës ku ato do të hapen.

### NENI 3- KOHËZGJATJA

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të papërcaktuar, duke nisur nga regjistrimi i saj pranë Regjistrimit Tregtar.

### NENI 4- OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqëria ka për objekt: *"Shërbime mjekësore, intervente, operacione, procedura mjekësore, diagnostike, qender mjekësore dhe laborator klinike biokimik, shërbime në specialitete të ndryshme mjekësore, konsulta mjekësore, diagnostifikim, eko të ndryshme, trajtime ambulatorë, trajtime mikrokirurgjikale, bashkëpunim me spitale, klinika, qendra mjekësore e farmaceutike të vendit dhe të huaja në ofrimin e shërbimeve mjekësore, ofrim i shërbimeve mjekësore sipas dhe në zbatim të orlentimeve mjekësore nga spitale të huaja të zgjedhur nga pacientet, asistence mjekësore, koordinim, trajtim mjekësor, shoqërim i pacientëve në institucione shëndetësore brenda dhe jashtë vendit etj, ofrim i trajnimeve dhe kryerjes së praktikës mjekësore, blerje, shitje pajisje mjekësore e produkte farmaceutike të ndryshme....."*

### NENI 5 - ORTAKET E SHOQËRISË

Ortakët e shoqërisë janë:

**1- Z. Ilirian Laçi**, i datelindjes 10/08/1980, lindur në Burrel dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtes i kartës së ID me Nr. 033830641 dhe nr. personal I00810063K, zotëruar i një 1 kuote kapitali, me vlerë të përgjithshme 50.000,00 lekë ,investime objekti dhe aparatura, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**2- Z. Benard Shehu**, i datelindjes 14/01/1980, lindur në Ballsh, Fier dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtes i kartës së ID me Nr. 037114589 dhe nr. personal I00114104E, zotëruar i një 1 kuote kapitali, me vlerë të përgjithshme 50.000,00 lekë, investime objekti dhe aparatura, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortakët, në përputhje me legjislacionin shqiptar marrin vendime në lidhje me: ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, transferimin të të tretët e pjesëve të kapitalit të Shoqërisë, emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve si dhe me emërimin e shkarkimin e ekspertit(eve) kontabël të autorizuar, levizjet e vlerave financiare dhe percaktimin e politika kryesore të shoqërisë përfshi dhe cmimet e shërbimeve apo percaktimin e nivelit të shpenzimeve se si do kryhen, miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si dhe të çdo raporti tjetër financiar, shpërndarjen e likuidimit të Shoqërisë, emërimin e likuidatorit (eve) e çdo vendim tjetër që sipas ligjit apo këtij statuti i takon Asamblesë së Ortakëve ose që shprehimisht është percaktuar se mund të jete objekt shqyrtimi në mbledhje Asambleje.

### KAPITALI THEMELTAR- PASURIA DHE FINANCIMI I SHOQËRISË

#### NENI 6 - KAPITALI I SHOQËRISË

Benard Shehu



- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000,00 (njqind mije) lek, i perbere nga 2 kuota, secila me vlere 50,000 leke, te cilat perfaqesojne 100 % te kapitalit te shoqerise. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme, të paluajtshme ose të drejta).
- 6.2 Kapitali i shoqërisë tregtare mund të shtohet ose pakësohet sipas vendimeve që do të marrin organet drejtuese të shoqërisë, duke i miratuar keto vendime me shumicen e të gjithë kuotave të shoqerise.
- 6.3 Pjesët e kapitalit të çdo ortaku janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.
- 6.4 Në rastin e kërkeses se largimit të ndonjerit prej ortakëve, kërkesa e tij do të shqyrtohet nga asambleja brenda periudhave të parashikuara nga ligji 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
- 6.5 Shoqëria detyrohet t'i likujdoje kuoten ortakut që do të largohet, dhe kuota e tij do të kalojë në favor të ortakëve të tjerë të shoqërisë në përpjestim të drejte me kuotat perkatese të ortakëve të tjerë që mbeten në shoqëri, pasi të jete bere likujdimi.
- 6.6 Shoqëria mund të shtojë numrin e ortakëve me miratimin unanimit të dy ortakëve. Miratimin unanimit nuk kërkohe vetem kur secili nga ortakët kërkon të bej dhurim të kuotave të tij tek bashkshortja, femijet ose prinderit.
- 6.7 Brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga shtimi apo pakësimi i numrit të ortakëve asambleja e ortakëve do të mbledhet dhe do të vendosë nese duhet të bej ndryshime të organeve drejtuese, administratoreve dhe statutit të shoqërisë.

## NENI 7 - ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Organi më i lartë i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, e cila përbëhet prej të dy ortakëve të shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme thirret dhe merr vendime të vlefshme sipas mënyrës së përcaktuar në kete statut dhe nese nuk është parashikuar në statut sipas dispozitave të ligjit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Asambleja e Ortakëve dhe administratoret e shoqërisë, kanë të drejtë që për nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të shoqërisë, të marrin në punë shtetas të ndryshëm, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, duke lidhur kontratë sipas kritereve që parashikohen në Kodin e Punës . Nese nje nga ortakët (Benard Shehu e Ilirian Laçi) të cilët janë edhe administratoret e shoqërisë nuk janë dakort me punesimin e nje personi të caktuar , nuk do të behet punesimi.

### Funksioni dhe Përgjegjësitë

Asambleja e Ortakëve perbehet nga ortakët e shoqërisë. Asambleja do të mbledhet duke respektuar ligjin shqiptar për shoqëritë tregtare dhe statutin e shoqërisë, në lidhje me administrimin, marrëdhëniet me shoqëri të tjera, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit transferimin e kuotave, për emërimin dhe zëvendësimin e Administratorit/administratoreve dhe Personave të Autorizuar, aprovimin e bilancit, shit-blerjen e aseteve të shoqërisë, krijimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit si dhe çdo vendim tjetër i cili duhet t'i parashtrohet Asamblesë së Ortakëve.

Asambleja e ortakëve mund të marre vendime për të marrë hua, për të dhënë hua, për të vendosur pronat e shoqërisë si kolateral, hipoteke, peng, garanci, dorezani, veprime bashkëpunimi me subjekte të tjera, investime në aktivitetin ose ambjentet e shoqërisë me vlere të konsiderueshme, vetem me miratimin

Benard  
m. e

D

unanim te te dy ortakeve, pra me miratimin e zoteruesve te 100% te kuotave. Nese veprimet e cituara me lart nuk jane kryer me miratimin 100% te ortakeve te shoqerise (aktualishte me miratimin unanim te te dy ortakeve) veprimet do te konsiderohen te pavlefshme.

### **Mbledhjet e Asamblesë së Ortakeve**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve do të mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit ushtrimor. Në këtë mbledhje të Asamblesë do të aprovohen nga ortakët raporti financiar i bilancit i aprovuar nga Administratori, do të percaktohet ne lidhje me shperndarjen e dividendit si dhe çështje të tjera të nevojshme. Asambleja e Ortakëve mund të mbledhet në mënyrë të rregullt, siç parashikohet në dispozitat ligjore nga secili prej dy ortakeve dhe nga secili Administrator per shkak se kane kuota te barabarta. Ne rast ndryshimi te numrit te ortakeve dhe pjeseve ne kuota do te veprohet sipas percaktimeve te ligjit. Vendimet e zakonshme te Asamblese se Pergjithshme do të merren me miratimin e te dy ortakeve. Mbledhjet e asamblese do te behen ne seline e shoqerise ose ne ndonje vend tjeter te rënë dakort nga Ortakët . Secili nga Administratorët qe do te tharres mbledhjen ju njofton Mbledhjen e Asamblesë, me letër rekomande ose e mail dhe nr telefoni njekohesisht, të paktën 10 ditë përpara mbledhjes. Lajmërimi përmban datën, adresën e vendtakimit dhe rendin e ditës së mbledhjes. Njoftimi do të bëhet në adresën Ortakut te cilen do ta depozitoj prane shoqerise ose ne adrese e banimit. Proçesverbalet e mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, nenshkruhen nga ortakët dhe administratorët, do të jenë në gjuhën shqipe dhe jane pjese e dokumentacionit te shoqerise. Vendimet nenshkruhen nga te dy ortakët. Secili nga administratorët ose ndonje person tjeter i autorizuar prej tyre mund te bej rregjistrimin e vendimeve te Asamblese prane QKB, nese eshte e nevojshme te rregjistrohen.

Për çdo çështje të shqyrtuar nga ortakët mbahet procesverbal në një regjistër të vecantë. Asambleja zhvillon mbledhje të zakonëshme dhe të jashtëzakonshme. Ajo thirret jo më pak se dy herë në vit, dhe ne çdo rast njoftimi per mbledhje do te jete me shkrim. Te gjithë procedurat e thirrjes se mbledhjes se asamblese, kuorumit te nevojshem per zhvillimin dhe vlefshmerine e mbledhjeve, kuorumit te nevojshem per marrjen e vendimeve dhe vlefshmerine e tyre, pervec rasteve te parashikuara ndryshe ne kete satut, do te jene sipas percaktimeve te bera ne ligjin nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqeritë tregtare" i ndryshuar, per funksionimin e shoqerive me pergjegjesi te kufizuar.

### **NENI 8 - ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

8.1 Shoqëria administrohet nga 2(dy) Administrator Z. Ilirian Laçi dhe Benard Shehu, me afat te pacaktuar.

8.2 Administratorët do të veprojnë te dy se bashku ne menyre te pandare, ne emer dhe per llogari te shoqerise duke e përfaqësuar shoqërinë përpara çdo autoriteti tatimor, doganor si dhe institucioneve të tjera të Republikës së Shqipërisë, para çdo organi gjyqesor dhe jo vetem, para çdo subjekti shtetëror, privat, vendas ose i huaj.

8.3 Administratorët nuk kane te drejte te tjetërsojne asnjë nga pronat e shoqërisë pa miratimin e shprehur me vendim te asamblese se ortakeve te shoqerise te miratuar ne unanimitet per aq kohe sa kuotat do te jene 50% me 50% ne emer te te dy themeluesve. Nese ndryshon raporti kuotave do te merren vendimet sipas ligjit.

Benard  
Shehu



8.4 Në zbatim të këtij neni, administratoret te dy se bashku përfaqësojnë Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshij këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratoret kane gjithashtu të drejtë të nënshkruajë edhe kontrata të ndryshme në emër e për llogari të Shoqërisë, duke përfshirë këtu kontratat e qirasë, shitjes, të nënshkruajnë aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku shoqëria është ortak si dhe ndryshimin e statutit të këtyre shoqërive, të nënshkruajë e hartojë çdo dokument e të kryejë në emër të shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo të huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të shoqërisë, nënshkrimin e kontratave të ndryshme bankare për financimin e shoqërisë, vetem pasi te jene miratuar ne Vendim Asambleje me shumice te gjithe kuotave te shoqerise.

8.5 Administratoret te dy se bashku mund të ndërmarrin apo kërkojnë kryerjen e të gjitha akteve që i konsiderojnë të nevojshme për arritjen e objektivave të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Asamblesë se Përgjithshme të Ortakëve apo organeve të tjera të Shoqërisë.

8.6 Administratoret jane te emëruar per një periudhe kohore 5 vjeçare, me të drejte ripërtëritjeje, dhe jane përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë.

8.7 Administratoret te dy se bashku emerojnë dhe punesojnë personat qe ju lind e nevojshme per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise.

8.8 Administratoret kane te drejte te autorizojne njeri tjetrin per te kryer veprime te natyres se administrimit te perditshem dhe kryejre pagesash qeraje, kundrejt shtetit apo fatura te shebrimeve te perditshme, fatura energjie, uji etj, duke i kryer normalisht vetem njeri prej administratorëve me miratimine administratorit tjetër.

8.9 Administratoret te dy se bashku merren me drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe kane te drejte e detyre te japin llogari në Asamblenë e Ortakëve .

8.10 Administratoret jane te detyruar te therrasin mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, ne rast se lind nevoja per marrje hua, dhenie hua, nese lind nevoja qe shoqeria te shese apo te disponoje ne menyre tjetër aktive ose prona te shoqerise, pavaresisht nga vlera e tyre, per zerin e Aktiveve Afatgjata (Financiar/Materiale/Biologjike/Jomateriale/Aktive tatimore te shtyra/Kapital i nenshkruar i papaguar), pasuri keto te luajtshme apo edhe te paluajtshme te shoqerise si dhe ne cdo rast tjetër te parashikuar nga ligji. Te gjitha keto veprime mund te behen vetem me miratimin unanimit te te dy ortakeve Benard Shehu dhe Ilirian Laçi.

8.11 Kapitali i shoqërisë është lirish i transferueshëm prej trashëgimtarëve të cdo ortaku në rast vdekjeje.

## NENI 9

9.1 Administratoret paguhen per punen qe bejne si administrator dhe nese kontribuojnë edhe si profesionit kane te drejte te marrin page ose te ardhura dhe nga kontributi si profesionist prane shoqerise. Se sa eshte pagesa percaktohet parimisht me vendim unanimit te te dy ortakeve, vendim qe zbatohet pastaj ne vijimesi. Cmimet e sherbimeve qe do te ofroj shoqeria do te miratohen me vendim nga te dy ortaket qe jane dhe themelues te shoqerise dhe do zbatohen nga Administratoret.

9.2 Asambleja me vendim unanimit te te dy ortakeve mund te vendose ndryshe nga pika 9.1, qe te mos paguhen me page per detyren si administrator por t'ju njihet një shpërblim vjetor, me miratimin ne menyre unanimit me 100% te te gjithe kuotave te shoqerise.

Benard

Ilirian 5

#### **NENI 10**

Administratoret te dy se bashku do të përfaqësoj shoqërinë me palët e treta gjatë gjykimeve dhe kane të drejtën e emërimit të avokatëve, juristëve, në kufijtë e përgjegjësive të lejuara.

Cdo kompetence te cituar më lartë qe administratoret e kane te dy se bashku, gjate ushtrimit te detyres se tyre mund ta delegojne tek njeri tjetri me shkrim per secilin veprim qe do kryhet vetem nga njeri administrator.

#### **NENI 11 - ZMADHIMI ose ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

11.1 Kapitali themeltar mund të zmadhohet me vendim unanim te të dy ortakëve te cilet zoterojne dhe 100% te kuotave. Ne kete proces kane te drejte te therresin ne mbledhje edhe ekspertin kontabel, finanacier, jurist ose punonjes qe e cmojne te arsyeshme te cilet japing mendimin profesional. Ne te njejten menyre do te veprohet edhe per zvogelimin e kapitalit.

11.2 Zvogëlimi i kapitalit nuk mund të bëhet nën minimumin e parashikuar në ligj.

#### **NENI 12- SHITJA E KUOTAVE**

12.1 Në përputhje me kufijtë dhe kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar, shitja e kuotave të kapitalit themelor i nënshtrohet në çdo rast të drejtës së blerjes nga ana e ortakëve të tjerë apo nga ana e shoqërisë me vendim asambleje, në përputhje me mënyrën dhe afatet për këtë zmadhim e tij të përcaktuara në këtë statut.

12.2 Për këte arsye, ortakët duhet të venë në dijeni ortakët e tjerë me letër rekomande me përgjigje, duke përcaktuar shumën e kërkuar dhe kushtet e pagesës.

12.3 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e letrës, ortakët e tjerë mund të vendosin të blejnë kuotën që është në shitje duke informuar shitësin mbi vendimin e tyre. Nëse të drejtën e blerjes dëshiron ta ushtrojë më shumë se një ortak, secili do të realizojë blerje me cmimin e kërkuar nga shitësi, në përpjestim me kuotën që zotëron.

12.4 Kur shitesi nuk merr njoftim brenda tridhjetë ditëve nga ortakët e tjere (njoftim me shkrim per shprehje interesi se duan te blejne kuoatat), atëherë do të kuptohet se është hequr dorë nga e drejta e blerjes prej ortakëve, dhe ortakut qe do te shes kuotata i lind e drejta ti shesi lirisht kuotat tek te tjere persona ose të bëjë kërkesë për largimin nga shoqëria, sipas kriterëve te ligjit.

#### **NENI 13- KONTROLLI KONTABËL**

13.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Ortakëve me vendim unanim te te dy ortakeve qe zoterojne 100% te kuotave, do të emërojnë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit dhe do percaktojen dhe pagesen per sherbimin .

#### **NENI 14 - FINANCIMI I SHOQËRISË**

14.1 Administratoret te dy se bashku do te menaxhojne financat e shoqerise ne llogarite Bankare dhe cash në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Per menaxhimin e financave japing llogari para Asamblese se Ortakëve. Administratoret ndermarrin te dy se bashku cdo veprim te

Bevd  
10.11

6

nevojshem për mirëadministrimin dhe mirëmenaxhimin e financave. Në çdo kohë mund të kërkojnë miratimin ose konsultimin e shpenzimeve, të ardhurave e financave në përgjithësi, në mbledhje të asamblejeve ku do të merren vendime për shtimin ose shkurtimin e shpenzimeve, menyrën e realizimit të të ardhurave etj..

14.2 Të ardhurat e shoqërisë sigurohen kryesisht nga shërbimet që do të kryerj shoqëria, financime të vete dy ortakëve, familjareve të tyre apo prej të tretëve, me shpërblim apo pa shpërblim, shërbime që do të kryejnë vete ortakët, shërbime nga subjekte të tjera, vendosje në dispozicion të shoqërisë mjetë të nevojshme, përdorimi i emrit të mirë të secilit ortak .

14.3 Asambleja ka të drejtë të vendosi në çdo kohë në lidhje me rezervat dhe sasinë e tyre, me miratimin me shumicë të gjithë kuotave të shoqërisë.

#### **NENI 11**

Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit në QKB, për njohjen dhe regjistrimin e saj si person juridik në Regjistrin Tregtar të kësaj qendre. Ushtrimin e aktivitetit tregtar e fillon pasi të jetë regjistruar dhe pajisur me certifikatat përkatëse në Organin e Tatimit Taksave, Tiranë. Shoqëria tregtare mund të ndryshojë emërtimin, vendqëndrimin dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë Asambleja e Përgjithshme.

#### **NENI 12**

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe atë Tregtar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore specifike për ushtrimin e saj, sipas objektit të veprimtarisë së saj, mbi bazën e Aktit të Themelimit dhe Statutit të saj dhe normat e së drejtës tregtare ndërkombëtare.

### **VITI FINANCIAR DHE BILANCI**

#### **NENI 13 - VITI FINANCIAR**

13.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti, përveç vitit të parë, i cili fillon nga data e regjistrimit dhe mbaron në fund të vitit.

#### **NENI 14 - LLOGARITË VJETORE**

14.1 Llogaritë vjetore, raporte mbi operacionet e veprimtarisë lidhur me vitin financiar dhe raportet e veçuara të hartuara nga administratorët dhe nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga asambleja me vendim unanim të dy ortakëve të cilët zoterojnë 100% të kuotave.

14.2 Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore të shoqërisë bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes së vitit financiar.

#### **NENI 15 - FITIMI**

15.1 Fitimet e shoqërisë pas shlyerjes së detyrimeve ndaj të tretëve, bashkëpunetoreve, të punësuarve, etj dhe shlyerjes së detyrimeve fiskale, i mbesin për përdorim ortakëve të shoqërisë të cilët i

*Beus*

*P* 7

ndajnë midis tyre 50% me 50% sic kane edhe kuotat. Ne te gjitha rastet dhe ne cdo lloj periudhe, do te merren ne shqyrtim per ndarjen e tyre ne formen e dividendeve midis ortakeve, vetem pasi te jene shlyer huamarrjet nga shoqeria prej ortakeve te saj apo familjareve te tyre te miratuara unanimisht nga Asambleja e ortakeve.

- 15.2 Ne te gjitha rastet dhe ne fund te cdo lloj periudhe ushtrimore, nese shoqeria rezulton me fitime te vitit ushtrimor dhe ne te njejten kohe rezulton me hua te marra prej ortakeve te saj (hua te marra ne unanimitet me vendim nga te dy ortaket qe kane 100% te kuotave) dhe ende te pashlyera, ne reference te pikes se mesiperme, detyrohet qe fitimin e realizuar prej saj deri ne vleren e huase se mbetur ende te pashlyer, ta paguaje ne drejtim te ortakeve huadhenes ne raport me gjendjen e pashlyer te huase dhe me specifikat perkatese te marreveshjeve te tyre. Ortaket e shoqerise nepermjet ketij statuti japin pelqimin ne menyre te pakundershtueshme per kthimin e huase se marre prej ortakeve ne momentin me te pare te mundshmen, me fitimet e realizuara nga shoqeria, sipas percaktimit te procedures se mesiperme, duke urdheruar Administratoret e shoqerise per ekzekutimin e ketij veprimi brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes te ushtrimit te mbyllur, duke e konsideruar kete statut si titull ekzekutiv.
- 15.3 Fitimet e shoqerise ndahen ne formen e dividendeve midis ortakeve pasi eshte mbajtur dhe tatimi perkates mbi dividendin.
- 15.4 Vendimi per caktimin e fitimeve (per shperndarjen e fitimeve, per caktimin e rezervave apo mosshperndarjen e fitimeve te vitit ushtrimor apo dhe fitimeve te mbartura), do te merret ne cdo rast ne mbledhjen perkatese te asamblese se ortakeve te shoqerise, me miratimin ne menyre anonime me 100% te te gjitha kuotave te shoqerise.
- 15.5 Cdo ortak ka te drejten e transferimit jashte vendit te pjeses se fitimit duke zbatuar dispozitat ligjore per kete transferim.
- 15.6 Asambleja e ortakeve mund te vendose qe te shperndahen shumat e fondeve te rezervuara duke treguar shprehimisht llojin e rezerves ku jane marrë, ne te njeten menyre te percaktuar si ne rastin e shperndarjes se dividendeve.


## NENI 16-BILANCI

- 16.1 Veprimtarite ekonomike dhe financiare te shoqerise mbyllen ne 31 Dhjetor te cdo viti. Administratoret shoqerise se bashku nxjerrin bilancin kontabel dhe raportin perkates ne perputhje me dispoziten ligjore per kontabilitetin.
- 16.2 Raporti i administrimit, inventaret, bilancet dhe llogarite vjetore te hartuara i nenshtrohen pa perjashtim miratimit nga Asambleja e ortakeve (ortaku i vetem) brenda afateve te caktuara.
- 16.3 Me miratimin e bilancit kontabel shoqeria vendos per fondet e nevojshme per zhvillimin si p.sh: fondi rezervë, atë te akumulimit, investimit etj.

## PRISHJA E SHOQËRISË DHE LIKUIDIMI

### NENI 17

**Shperndarja ose prishja** e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilen eshte krijuar, siç mund te jenë:



- A) Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj.
- B) Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji "Për falimentimin e Shoqërive Tregtare"
- C) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.
- D) Kur te dy ortaket ne menyre unanime bien dakort ta prishin shoqerine.

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilën parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në Likuidim e sipër".

Shoqëria duhet të kryejë procesin e likuidimit në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Afati i emërimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar në Aneksin e Regjistrimit Tregtar pranë QKB. Likuidatori është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt, si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilëve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve debive që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçantë apo personave fizik apo juridik, vendas apo të huaj.

## DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

### NENI 18-KONFLIKTET

Të gjitha mosmarrëveshjet brenda shoqërisë që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, do të shqyrtohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### NENI 19

28.1 Ky statut ne pergjithesi, mund te ndryshohet me vendimin unanimit te te dy ortakeve ne mbledhjen e asamblese te cilet zoterojne 100% te kuotave te kapitalit, ne perputhje me percaktimet e ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndersa ne lidhje me nenet 6, 7, 22, 23 dhe 26 te ketij do te ndryshohen vetem me vendimin e asamblese se ortakeve me miratimin ne shumice te te gjithë kuotave te shoqerise.

28.2 Përsa nuk është shprehur në këtë statut, të gjitha rregullimet e nevojshme do të bëhen nga Asambleja e Përgjithshme apo nga të dy Administratorët së bashku duke iu referuar plotësimeve të percaktuara ne dispozitat e ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi ne RSH.

28.3 Cdo ndryshim e plotësim në statut nuk prek personalitetin juridik të shoqërisë tregtare "TIRANA POLYCLINIC" SH.P.K.

### NENI 20

Ky statut u redaktua në 5 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga ortakët themelues të shoqërisë nënshkruhet në të gjitha

*Beud*  
*10/11/14*

*[Signature]*

kytjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre origjinale, autenticiteti i të cilës vërtetohet nga Noteri.

**ORTAKËT**

Bens Çyçku

Bens  
Çyçku

Sabiraj Laçi

[Signature]

**NOTERI**

[Signature]

